



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

**"RISITË DHE PROBLEMATIKAT NË ZBATIMIN
PËR HERË TË PARË TË SKK-VE TË PËRMIRËSUARA"**

07 Qershor 2016, Hotel Tirana International (Salla Abret)

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, më datë 7 qershor 2016, organizon në mjediset e Hotel Tirana International, Salla Abret, Konferencën Kombëtare me temë "Risitë dhe problematikat në zbatimin për herë të parë të SKK-ve të përmirësuara".

Qëllimi i kësaj Konference Kombëtare është të vlerësojë ecurinë e reformës në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar prej vitit 2013 deri sot, një reformë ku përfshihen tre aktorë kryesorë, hartuesi i standardeve, hartuesi i pasqyrave financiare dhe përdoruesi final i informacionit financiar.

Përmbajtja - Në Konferencën e zhvilluar nga KKK në Maj 2013, u paraqit vizioni dhe ambicia e këtij organizmi rregullator për të bërë një hap cilësor në reformën e raportimit financiar duke përafuar kërkesat e ligjit dhe të standardeve të kontabilitetit me kërkesat e Direktivës më të fundit të BE për kontabilitetin si dhe me kërkesat e rregullatorit ndërkombëtar të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Fokus ishin njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.

Në Konferencën e 7 qershorit 2016, KKK vjen për të ndarë me palët e interesit gjithçka mbi rrugën e shkelur dhe punën e bërë në këtë drejtim në këto 3 vite, por jo vetëm kaq. Bashkëpunëtorët dhe palët e interesit, përfaqësues të hartuesve dhe përdoruesve të informacionit dhe pasqyrave financiare, vijnë në konferencë për të treguar risitë dhe problematikat, arritjet dhe mosarritjet, pse jo edhe propozimet e tyre për të përmirësuar standardet kombëtare të kontabilitetit në të ardhmen. Përmirësimi është sfidë dhe domosdoshmëri.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet do të jenë përfaqësues të Kuvendit, të Institucioneve Shtetërore, të Organizmave Rregullatorë Homologë, të Akademisë Universitare, të Organizmave Profesionalë, të Biznesit dhe Dhomave të Tregtisë si dhe miq e të ftuar të Organizmave Ndërkombëtarë.

Ju falenderojmë për praninë tuaj,